Raportim hulumtimi në datat 6-8 Dhjetor 2026 (Devolli i POSHTEM)

Specialistë arkitektë:
Dr. Loreta Çapeli
Dr. Ledita Mezini

Në zbatim të qëllimit dhe objektivave të projektit "Vendbanimet dhe banesat fshatare në Shqipërinë Jugore", me drejtues projekti Prof. Dr. Pirro Thomo, stafi shkencor që përfshin Dr. Loreta Çapeli dhe Dr. Ledita Mezini kanë kryer vizitën në zonën e Devollit në Korçë, krahinë që është caktuar për tu eksploruar, gjurmuar e njohur me zonën dhe ndërtimet e fshatrave të saj dhe identifikimin paraprak të ndërtimeve, kompleksëve, apo edhe të rrënojave, të vendbanimeve më të hershme që kanë potencial dhe vlera të trashëgimisë kulturore, që duhen ruajtur. Vizita eshte kryer në datat 06-08 Dhjetor 2025.
Për evidentim dhe memorizim Mapping të objekteve u përdor aplikacioni "Save location" në të cilin u memorizuan vendodhja me koordinatt GIS, adresa e objektit dhe nje foto identifikuese e tij.
Në përfundim të udhëtimit hulumtues harta e aplikacionit tregon vendodhjen e te gjithe objekteve të skeduar dhe të identifikur si objekte me vlerë arkitektonike, kompozicionale, historike apo të dhe të teknologjisë së ndërtimit, karakteristike për zonën.



FOTO: screenshot me pozicionet nga aplikacioni

U vizituan dhe u evidentua Banesa fshatare në fshatrat e mëposhtme:

1. Pendavinj

Gjatë vizitës u vizitua qendra e fshatit dhe zonat periferike të tij. Gjatë hulumtimit u vu re se pjesa më e madhe e ndërtesave janë rikonstruktuar duke e humbur formën origjinale arkitektonike dhe ndërtimore. Megjithatë u vu re modeli kompozicional i përdorur në zonë, i cili si një ndërtesë 1 katëshe apo 2 katëshe përbëhet nga një bllok kompakt ndërtimor, me planimetri gjatësore, çati kater ujëse, dhe dritare drejtkëndore me ose pa hark mbajtës mbi të. Teknika e murit është e përzier si një kombinim i gurit dhe tullës, me kënde të detajuar me blloqe të mëdhenj guri dhe me tullën të përdorur si element dekorativ për harqet apo për kornizat e dritareve. Ky material eshte ne dukje sepse muret jane te pasuvatuar. Në mure rrethues përdoret qerpiçi si material me kosto më të ulët. Muret prej qerpiçi janë me trarë të hollë horizontalë prej druri.

2. Cangonj

Në fshat i kanë rezistuar kohës pak shtëpi të tipit drejtkëndor me planimetri simetrike dhe mbulim me çati katërujëse.

Muret janë ndërtuar me gurë e tullë, në të cilët këndet janë me blloqe të mëdhenj të rregullt, ndërkohë që pjesa ndërmjet me gurë të parregullt, dhe kornizat e çative me tullë të rregullt qeramike. Objektet me poshtë janë disa prej shtëpive të evidentura. Paraqitet tiologjia e shtëpisë fshatare me oborr, në të cilin si një ndërtesë më vete, shpesh prej qerpiçi, ndodhet hauri apo ambjenti i magazinimit të produkteve bujqësore.

3. <u>Vranisht</u>

Në këtë fshat shfaqen karaktaristike dekoracionet me punim të variueshëm të suvasë, duke formuar motive floreale mbi sipërfaqet e fasadave. Në Vranisht shfaqen masivisht edhe qerpiçi si material ndërtimor, duke e përdorur kryesisht në katet e dyta të ndërtimeve të karakterit magazinë.

Interes paraqet sistemi urban i fshatit, me rrugë vernakulare që krijojnë degëzime të shpeshta. Në hapësirën me kënd të ngushtë që krijohet nga këto rrugë vendosen objekte me planimetri në formë të një katerkëndëshi të parregullt.





4. <u>Pilur</u>

Piluri ruan të njëjtat karakteristika si fshati i Vranishtit. Me më pak shtëpi, ai duket si një lagje e Vranishtit, duke u ndarë vetëm nga një rrugë prej tij.

Në këtë ekspeditë nuk u evidentua objekt me vlerë historike dhe arkitektonike i tipit shtëpi fshatare, në këtë fshat.

5. Baban

Vizitën pasardhëse u bë në fshatin Baban.

Shtëpi të shumta prej qerpiçi të cilat mbeten si ndërtime 1 katëshe për vetë vështirësinë e ngritjes në 2 kate të një shtëpie me material të tillë ndërtimor. Në këtë fshat vihet re se në rastin e nevojës për ndërtim 2 katësh, kombinohet qerpiçi me gurin duke ndërtuar me gurë paretet nga veriu ose nga lindja dhe duke bërë me qerpiq paretet nga jugu ose perëndimi. Në këtë fshat ka akoma grupe shtëpish prej qerpiçi të cilat mund të shpallen në ruajtje për vetë teknologjinë e ndërtimit që përdorin dhe për mënyrën vernakulare të organizimit, në respekt të prezencës volumetrike të njëra tjetrës.

6. Sul

Gjatë vizitës në Sul u vu re se edhe në në këtë fshat ruhen akoma shumë ndërtime prej qerpiçi duke evidentuar karakteristikën se këto fshatra kanë preferuar Qerpiçin kundrejt gurit. Gjendja e shtëpive prej qerpiçi paraqitet e dëmtuar në disa raste, por në përgjithësi ato qëndrojnë mirë duke formuar grupime shtëpish me të njëjtën teksturë e kromatizëm, dhe me volumetri të thjeshtë. Objektet dy katësh janë me material guri dhe tulle në dukje, duke e përdorur kombinimin e këtyre dy materialeve edhe si vlerë estetike të fasadave të pa suvatuara. Në Sul interes paraqesin edhe situatat urbane, me grupe shtëpish apo magazinash të ndërtuar me qerpiç.

7. Ziçisht